



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1059 Prot.

Tiranë, më datë 25.7:2023

VENDIM
Nr. 436, datë 25.07.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 25.07.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e Konceptit të plotë të Gërmimeve Arkeologjike, për zonën e *Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin dhe Banjave Romake*, në përputhje me VKM nr. 220, datë 7.4.2021 “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike”, në kuadër të projektit “*Hartimi i Planeve të Konservimit dhe Gërmimeve Arkeologjike të Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin dhe Banjave Romake dhe të Shtigjeve Urbane në Zonat Arkeologjike “A” dhe “B” të Qytetit të Durrësit*”, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me aplikues shoqëria “Taulant” sh.p.k., dhe zhvillues **Ministria e Kulturës dhe AADF**.
 2. Të vijojë me realizimin e Gërmimeve Arkeologjike për Fazën e I – rë dhe rezultatet e gjetjeve arkeologjike të paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë KKTKM;
 3. Pas përfundimit të Fazës së I-rë të Gërmimeve Arkeologjike, rezultatet ti vihen në dispozicion projektit “*Prezantimi/ Interpretimi dhe Valorizimi i Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin, Banjave Romake dhe i Shtigjeve Urbane në Zonat Arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit dhe Itinerari i Vizitorëve*”;
 4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
 6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta Qirici

